



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Udhëzim i Njesisë së Paraburgimit

Rregullore e Brendshme e Objektivit të Paraburgimit

Miratuar nga:	Administratorja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	23 shtator 2020
Lëshuar nga:	Shefi i paraburgimit
Lëshuar më:	23 shtator 2020
Data e hyrjes në fuqi:	23 shtator 2020
Zëvendëson:	Nuk ka
Numri:	KSC-BD-29

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Udhëzim i Njesisë së Paraburgimit mbi Rregulloren e Brendshme të Objektivit të Paraburgimit
KSC-BD-29

Përmbajtja

PJESA 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
PJESA 2	PËRMBLEDHJE E SHTOJCAVE	2
PJESA 3	RISHIKIMI DHE NDRYSHIMET	3

Pjesa 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Ky Udhëzim është lëshuar nga shefi i paraburgimit i Njesisë së Paraburgimit të Dhomave të Specializuara në përputhje me rregullën 4.6 të Rregullores së Paraburgimit, pas miratimit prej Administratores. Ai përcakton rregullat e funksionimit të përditshëm të objektivit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara, i cili gjendet në burgun holandez në Hagë ('burgu'), për garantimin e sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit.
2. Ky Udhëzim zbatohet brenda objektivit të paraburgimit, që përbëhet nga blloku i qelive dhe zyrat administrative të Njesisë së Paraburgimit brenda burgut. Disa prej mjediseve gjenden jashtë bllokut por janë pjesë e objektivit të paraburgimit duke qenë se përdoren për funksione të Njesisë së Paraburgimit, në veçanti salla e vizitave, dhomat për vizita private, klasat, biblioteka, dhoma për nevoja fetare dhe shpirtërore, shërbimi mjekësor, oborri për ajrim, ballkoni për ajrim, palestra dhe salla e sporteve.
3. Për administrimin e disiplinës në objektin e paraburgimit, kur është relevante, ky Udhëzim zbatohet për të paraburgosurit edhe kur ata nuk janë fizikisht të pranishëm në objektin e paraburgimit, përfshirë gjatë kohës që janë në tranzit për në dhe nga mjediset e Dhomave të Specializuara, apo kur janë brenda këtyre mjediseve.
4. Ky Udhëzim interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit dhe udhëzuesit e punës të renditur në rregullën 63 të Rregullores së Paraburgimit, si dhe me çfarëdo udhëzuesi pune apo udhëzimi tjetër të miratuar ose lëshuar në pajtim me rregullën 4 të Rregullores së Paraburgimit.
5. Në pajtim me nenin 7.2 të Udhëzuesit të Punës mbi Disiplinën, i paraburgosuri mund të kryejë shkelje disiplinore në qoftë se nuk u bindet kërkesave të këtij Udhëzimi.

Pjesa 2 Përmbledhje e shtojcave

1. Shtojcat e këtij Udhëzimi janë pjesë përbërëse e tij.
2. Shtojca A, 'Rregullore e Brendshme' është e organizuar në bazë të temave konkrete, në kuadër të të cilave:
 - a. përcakton rregullat bazë për të paraburgosurit, të cilat duhet të zbatohen në jetën e tyre të përditshme në objektin e paraburgimit, në përputhje me rregullën 12.3.g të Rregullores së Paraburgimit; dhe
 - b. shpjegon të drejtat, detyrimet dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të gjitha aspektet e tjera të parapara në rregullën 12.1 të Rregullores së Paraburgimit, duke bërë përmbledhjen e elementëve kryesorë të Rregullores së Paraburgimit dhe të udhëzuesve të punës të renditur në rregullën 63 të Rregullores së Paraburgimit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Udhëzim i Njësisë së Paraburgimit mbi Rregulloren e Brendshme të Objektivit të Paraburgimit
KSC-BD-29

3. Shtojca B 'Përdorimi i qelive për mbajtjen e dokumenteve' përcakton rregullat për përdorimin e një qelie për mbajtjen e dokumenteve, e cila mund t'i caktohet një të paraburgosuri për mbajtjen e materialeve që kanë lidhje me çështjen gjyqësore, sipas rregullës 26.1 të Rregullores së Paraburgimit dhe Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve.

Pjesa 3 Rishikimi dhe ndryshimet

Shefi i paraburgimit e rishikon këtë Udhëzim në mënyrë periodike dhe mund ta ndryshojë atë, si edhe shtojcat e tij, ose të lëshojë shtojca të reja me miratimin e Administratorit, në përputhje me rregullën 4.6 të Rregullores së Paraburgimit.



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Shtojca A

Rregullorja e Brendshme

Përmbajtja

1.	OBJEKTI I PARABURGIMIT.....	2
2.	ZBATIMI I RREGULLORES SË BRENDSHME.....	2
3.	KORNIZA LIGJORE.....	2
4.	KUSHTET E PËRGJITHSHME.....	3
5.	GJUHA.....	3
6.	SHËRBIMET JURIDIKE	3
7.	PËRFAQËSUESIT KONSULLORË.....	6
8.	QELIA E TË PARABURGOSURIT DHE LËVIZJET JASHTË QELISË	6
9.	SENDET E NDALUARA	7
10.	SHËRBIMI MJEKËSOR	7
11.	USHQIMI.....	8
12.	DYQANET	8
13.	LLOGARIA.....	9
14.	VESHJA DHE SENDE TË TJERA PERSONALE	10
15.	HIGJENA PERSONALE.....	10
16.	AJrimi DHE USHTRIMET FIZIKE	11
17.	AKTIVITETE TË TJERA.....	11
18.	PIRJA E DUHANIT	12
19.	THIRRJET TELEFONIKE DHE POSTA.....	12
20.	VIZITAT.....	14
21.	MIRËQENIA SHPIRTËRORE.....	17
22.	VAJTJA NË SEANCA GJYQËSORE DHE MUNGESA NGA SEANCAT GJYQËSORE.....	18
23.	KONTROLLET.....	18
24.	MASAT SHTRËNGUESE DHE TË KONTROLLIT	19
25.	DISIPLINA E TË PARABURGOSURVE.....	19
26.	ANKESAT E TË PARABURGOSURVE.....	19
27.	DOSJA PERSONALE	20

1. OBJEKTI I PARABURGIMIT

Objekti i paraburgimit gjendet brenda një burgu holandez në Hagë ('Burgu'). Dhomat e Specializuara e përdorin objektin e paraburgimit për mbajtjen në paraburgim të personave.

Qelitë e të paraburgosurve gjenden brenda objektivit të paraburgimit. Disa mjedise ndodhen jashtë bllokut, mirëpo ato janë pjesë e objektivit të paraburgimit kur përdoren për funksionet e Njesisë së Paraburgimit ("NJP") të Dhomave të Specializuara, konkretisht salla e vizitave, dhomat për vizita private, klasat, biblioteka, dhoma për nevoja fetare e shpirtërore, shërbimi mjekësor, oborri për ajrim, veranda, palestra dhe salla e sporteve.

Objekti i paraburgimit është një vend i sigurt me videombikëqyrje dhe videoincizim 24-orësh. Sidoqoftë brenda dhomave për vizita private, banjave, hapësirave për dushe, ose mjedisëve për shërbimin mjekësor nuk ka videombikëqyrje ose videoincizim. Oficerët e paraburgimit që janë të pranishëm në mjedise të ndryshme të objektivit të paraburgimit gjithashtu mbikëqyrin veprimtarinë në këto mjedise. Si rregull, qelitë e të paraburgosurve nuk mbikëqyren me video, mirëpo Administratori mund të marrë vendim për videombikëqyrje të një qelie dhe njofton të paraburgosurin në lidhje me këtë.

2. ZBATIMI I RREGULLORES SË BRENDSHME

Kjo Rregullore e Brendshme zbatohet dhe duhet të respektohet brenda objektivit të paraburgimit, duke përfshirë edhe mjediset jashtë bllokut që përdoren për funksionet e Njesisë së Paraburgimit (shih pjesën 1. OBJEKTI I PARABURGIMIT më lart).

Për administrimin e disiplinës në objektin e paraburgimit, kjo Rregullore e Brendshme zbatohet sipas rrethanave për të paraburgosurit edhe kur përkohësisht nuk ndodhen në objektin e paraburgimit, për shembull kur janë në mjediset e Dhomave të Specializuara në Raamweg 47 për të marrë pjesë në seanca, ose kur janë në spital për mjekim.

Në rast se gjuha e të paraburgosurit nuk është një ndër gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, përkatësisht shqipja, serbishtja, ose anglishtja, të paraburgosurit i jepet Rregullorja e Brendshme në një gjuhë që e kupton.

Rregullorja e Brendshme është hartuar sipas temave konkrete. Nëse nuk kupton diçka, i paraburgosuri mund të kontaktojë shefin e paraburgimit ose dikë tjetër nga personeli i Njesisë së Paraburgimit për sqarim.

3. KORNIZA LIGJORE

Rregullorja e Brendshme jep një përmbledhje të kornizës ligjore përkatëse për të paraburgosurit, sikurse përcaktohet në Rregulloren e Paraburgimit dhe në udhëzuesit e punës në lidhje me të. Gjithashtu, kjo Rregullore specifikon detyrimet dhe procedurat përkatëse për të paraburgosurit në objektin e paraburgimit dhe burgun e sigurisë së lartë dhe lëshohet në bazë të paragrafëve 4, 5 dhe 6 të rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit.

Në çdo kohë, Administratori mund të miratojë udhëzues pune ose udhëzime shtesë dhe shefi i paraburgimit mund të lëshojë udhëzime shtesë në lidhje me të paraburgosurit.

Të paraburgosurit marrin kopje të të gjitha teksteve juridike përkatëse dhe dokumenteve të tjera në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë mbajtjes së tyre në objektin e paraburgimit. Të paraburgosurit duhet të njihen me dokumentet e lartpërmendura juridike.

4. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Shefi i paraburgimit, duke vepruar nën autoritetin e Administratorit, ka përgjegjësinë parësore për garantimin e sigurisë dhe të rregullit në objektin e paraburgimit, për mbajtjen e sigurt të të gjithë të paraburgosurve, për trajtimin e tyre të sigurt dhe njerëzor dhe për garantimin e të drejtave të tyre. Shefi i paraburgimit ka gjithashtu përgjegjësi parësore për garantimin e sigurisë së vizitorëve të të paraburgosurve dhe personave të tjerë në objektin e paraburgimit.

Për garantimin e sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit, shefi i paraburgimit ka kompetencë të lëshojë udhëzime dhe t'u japë urdhra të paraburgosurve dhe personave të tjerë, si p.sh. vizitorëve të cilët janë të pranishëm në objektin e paraburgimit, si edhe ka kompetencë të ndërmarrë masa në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit. Këtë kompetencë e kanë edhe oficerët e paraburgimit që veprojnë me autorizim të shefit të paraburgimit.

Të paraburgosurit dhe personat e tjerë brenda objektivit të paraburgimit, përfshirë vizitorët, duhet t'u binden urdhrave dhe udhëzimeve të shefit të paraburgimit dhe oficerëve të paraburgimit.

Në rast se një i paraburgosur kërkon t'i paraqesë kërkesë shefit të paraburgimit, që kërkesa të shqyrtohet dhe të marrë përgjigje, ajo duhet të paraqitet **me shkrim**. I paraburgosuri mund ta dërgojë kërkesën me shkrim përmes postës dalëse, ose mund t'ia japë një oficeri të paraburgimit në bllokun e vet.

5. GJUHA

Për administrimin e efektshëm të objektivit të paraburgimit, personeli i Njesisë së Paraburgimit përdor për komunikim anglishten si një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara. Nëse të paraburgosurit nuk mund të komunikojnë efektivisht me personelin e Njesisë së Paraburgimit në gjuhën angleze, atyre u sigurohet përkthim që të mund të komunikojnë lirisht.

Në qoftë se një i paraburgosur nuk është në gjendje të komunikojë me personelin e Njesisë së Paraburgimit për çfarëdo çështje, atëherë i paraburgosuri mund t'i referohet kësaj pjese dhe personeli do të bëjë kërkesë për përkthyes.

Në komunikimet me shkrim, të paraburgosurit mund të përdorin anglishten, serbishten ose shqipen, ose gjuhën e tyre nëse nuk janë të rrjedhshëm në asnjë prej këtyre tri gjuhëve.

6. SHËRBIMET JURIDIKE

Të paraburgosurit kanë të drejtë për shërbime juridike prej mbrojtësve që zgjedhin vetë, të cilët janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, ose mbrojtës që i përmbushin kriteret e pranimit për në Listën e Mbrojtësve të Specializuar. Zyra e Mbrojtjes u jep të paraburgosurve Listën e Mbrojtësve

të Specializuar dhe dokumente e informacion të mëtejshëm se si të marrin në shërbim mbrojtës. Zyra e Mbrojtjes njoftohet për pranimin e një të paraburgosuri në objektin e paraburgimit.

Në rast se tashmë ka një mbrojtës, të paraburgosurit i jepet mundësi që pa vonesë të kontaktojë me telefon mbrojtësin e vet pas intervistës së mbërritjes në objektin e paraburgimit.

- **Konfidencialiteti i komunikimit mbrojtës-klient**

Të paraburgosurit mund të komunikojnë me mbrojtësit e tyre përmes **telefonit**. Të paraburgosurit mund t'u dërgojnë **letra** mbrojtësve të tyre, sa herë të dëshirojnë. Të paraburgosurit gjithashtu mund të kenë vizita prej mbrojtësve të tyre (shih pjesën 19. THIRRJET TELEFONIKE DHE POSTA dhe pjesën 20. VIZITAT më poshtë). Nëse autorizohet prej Administratorit, të paraburgosurit mund të kenë vizitë përmes videolidhjes me mbrojtësit e tyre në bazë të procedurës së parashtruar në një udhëzim të veçantë.

Thirrjet telefonike (vetëm përmes linjës telefonike të mbrojtur), posta dhe vizitat e mbrojtësve për të paraburgosurit janë të privileguara dhe konfidenciale.

Të paraburgosurit mund të përdorin linjën e mbrojtur telefonike për thirrje telefonike dalëse, konfidenciale me mbrojtësin. Linja telefonike jo e mbrojtur nuk duhet të përdoret për komunikime konfidenciale me mbrojtësin.

Letërkëmbimi midis të paraburgosurve dhe mbrojtësve të tyre nuk lexohet, mirëpo mund t'u nënshtrohet kontroleve të sigurisë për aq sa është e domosdoshme për verifikimin e pranisë së sendeve të ndaluara në bazë të rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit. Në rast dyshimi për praninë e një sendi të ndaluar, letërkëmbimi mund të hapet vetëm në pranimin e dërguesit (i paraburgosuri ose mbrojtësi i vet), vetëm për të verifikuar nëse letërkëmbimi përmban një send të ndaluar.

Vizitat e mbrojtësve kryhen brenda rrezes së shikimit të oficerëve të paraburgimit, por jo brenda rrezes së dëgjimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Për të mundësuar që vizita prej mbrojtësit të kryhet brenda rrezes së shikimit, të paraburgosurit mund t'i kërkohet që gjatë vizitës prej mbrojtësit, të qëndrojnë ulur në një karrige të caktuar në dhomën për vizita të mbrojtësve.

Administratori mund të caktojë kufizime të përkohshme mbi konfidencialitetin e vizitave dhe komunikimeve në rrethana të jashtëzakonshme, për shembull kur kufizime të tilla janë të domosdoshme për të parandaluar keqpërdorimin e konfidencialitetit të komunikimit mbrojtës-klient për kryerjen e një krimi. Të paraburgosurit dhe mbrojtësit e tyre informohen për këto kufizime të përkohshme para hyrjes së tyre në fuqi.

Vizitat dhe komunikimet me mbrojtësit mund të jenë edhe objekt i disa kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale të caktuara prej gjykatësve të Dhomave të Specializuara.

- **Vizitat e mbrojtësve**

- *Orari i vizitave*

Vizitat e mbrojtësve mund të kryhen midis orës **9:00** dhe **16:45** nga **e hëna në të premte**. Para vizitës, mbrojtësit duhet të kontaktojnë zyrën e administrimit të Njësisë së Paraburgimit ('zyra e administrimit') për planifikimin e vizitës së tyre (shih pjesën 20. VIZITAT më poshtë).

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Shtojca A Rregullorja e Brendshme e Objektivit të Paraburgimit
KSC-BD-29

Në qoftë se për shkak të orarit të seancave gjyqësore në Dhomat e Specializuara, i paraburgosuri nuk mund të takojë mbrojtësin e vet gjatë orarit të rregullt të vizitave për përgatitjen e mbrojtjes, shefi i paraburgimit mund të autorizojë vizita jashtë këtij orari, duke përcaktuar kushte specifike.

Orari i vizitave mund të ndryshohet për arsye që kanë të bëjnë me personelin, ose arsye të tjera operative. Nëse është e mundshme, të paraburgosurit dhe mbrojtësit e tyre informohen paraprakisht për ndryshimin e orarit të vizitave.

◦ *Materialet që sillen dhe që shkëmbehen gjatë vizitave*

Në vizitat e mbrojtësve, të paraburgosurit dhe mbrojtësit e tyre mund të sjellin dokumente shkresore, CD ose DVD që përmbajnë komunikime të privileguara, dokumente të punës së kryer ose që kanë lidhje me çështjet gjyqësore, si dhe materiale të tjera për përgatitjen e mbrojtjes, sikurse përcaktohet në rregullën 26 të Rregullores së Paraburgimit.

Në vizitat e mbrojtësve, të paraburgosurit dhe mbrojtësit e tyre mund të shkëmbejnë drejtpërsëdrejti dokumente shkresore për përgatitjen e mbrojtjes. Nëse dëshirojnë të shkëmbejnë CD ose DVD që përmbajnë material për përgatitjen e mbrojtjes, ata duhet të zbatojnë procedurën për shkëmbimin e këtyre materialeve, sikurse përcaktohet më poshtë.

Mbrojtësve u ndalohet të sjellin në objektin e paraburgimit pajisje që mund të përdoren për incizim ose komunikim, ndër të cilat telefona mobilë dhe sende të tjera të ndaluara sipas rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit. Sidoqoftë, mbrojtësit mund të sjellin dhe të përdorin gjatë vizitave kompjuterët e tyre të bartshëm (*laptop*) që përmbajnë materiale për përgatitjen e mbrojtjes. As të paraburgosurit, as mbrojtësit nuk mund të përdorin kompjuterët e bartshëm për incizim ose komunikim, ndër të tjera nëpërmjet përdorimit të kamerave ose të aplikacioneve si *Skype*.

Për shkak të sigurisë së lartë në objektin e paraburgimit, ose për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve ose të tjerëve, Administratori ose shefi i paraburgimit mund të vendosë kufizime të përgjithshme mbi sendet e sjella në vizitat e mbrojtësve, të tilla si kompjuter i bartshëm personal. Në raste të tilla, dokumentet shkresore dhe materiale të tjera për përgatitjen e mbrojtjes lejohet të shkëmbehen përmes procedurës për shkëmbimin e këtyre materialeve, sikurse përshkruhet më poshtë.

◦ *Shkëmbimi i CD-ve dhe DVD-ve për përgatitjen e mbrojtjes*

Nëse ka ndër mend të japë CD dhe DVD që përmbajnë material për mbrojtje, i paraburgosuri ia dorëzon ato oficerit të paraburgimit në bllokun ku ndodhet qelia e të paraburgosurit, së paku një ditë pune më herët, së bashku me një formular të plotësuar siç kërkohet për këtë qëllim. Nëse mbrojtësit dëshirojnë të sjellin me vete CD dhe DVD, ata ia dorëzojnë këto CD dhe DVD personelit të Njësisë së Paraburgimit në hyrjen e objektit të paraburgimit, së bashku me një formular të plotësuar siç kërkohet për këtë qëllim.

Zyra e administrimit i regjistron CD-të dhe DVD-të dhe gjithashtu verifikon nëse ato mund të jepen ose merren në përputhje me nenin 11 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet me Mbrojtësit dhe i kontrollon nëse përmbajnë sende të ndaluara. Njësia e Paraburgimit nuk mbikëqyr në asnjë lloj mënyre të dhënat që përmbajnë CD-të dhe DVD-të dhe respekton konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient.

CD-të dhe DVD-të që lejohen të sillen, etiketohen dhe i dorëzohen të paraburgosurit i cili nënshkruan për marrjen e tyre. CD-të dhe DVD-të që lejohet të nxirren, i jepen mbrojtësit në kohën kur del nga

objekti i paraburgimit. Vetëm mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi i një të paraburgosuri mund të marrë CD ose DVD dhe të nënshkruajë për marrjen e tyre.

- **Mjetet dhe mundësitë për përgatitjen e mbrojtjes**

Në rast të sasive të mëdha të materialeve për përgatitjen e mbrojtjes, i paraburgosuri mund t'i paraqesë kërkesë shëfit të paraburgimit për një qeli ("qelia për mbajtjen e materialeve") e cila zakonisht gjendet në bllokun ku ndodhet qelia e të paraburgosurit, për mbajtjen e materialeve që lidhen me çështjen gjyqësore. Nëse disa të paraburgosur paraqesin kërkesë për një qeli për mbajtjen e materialeve, secilit të paraburgosur i jepet një dollap i veçantë në këtë qeli e asnjë i paraburgosur tjetër nuk ka qasje në atë dollap. Në qelitë ose në dollapët për mbajtjen e materialeve nuk mund të mbahen gjësende të tjera si tesha, apo sende personale të tjera.

Çdo i paraburgosur mund të bëjë kërkesë për një kompjuter, për ta përdorur kryesisht për përgatitjen e mbrojtjes në proceset në Dhomat e Specializuara. Të paraburgosurit ia dërgojnë kërkesën zyrës për administrim. Pajisja me kompjuter e të paraburgosurit nuk përbën të drejtë, por privilegj. Gjithashtu një i paraburgosur dhe mbrojtësi i vet do të duhet të shprehin pajtimin e tyre me kushtet e përdorimit të kompjuterit, nëpërmjet nënshkrimit të tyre.

7. PËRFAQËSUESIT KONSULLORË

Të paraburgosurit mund të komunikojnë dhe të presin vizita prej përfaqësuesve të tyre konsullorë. Të paraburgosurit mund t'i gjejnë të dhënat e kontaktit të zyrave konsullore në objektin e paraburgimit. Pa vonesë pas intervistës së mbërritjes, i paraburgosuri mund të kontaktojë me telefon zyrën konsullore, ose të bëjë kërkesë që zyra konsullore të informohet për pranimin e tij në objektin e paraburgimit. Kjo kërkesë përcillet pa vonesë.

Të paraburgosurit mund të kenë vizita prej përfaqësuesve konsullorë. Vetëm Administratori ka kompetencë për lejimin e këtyre vizitave. Vizitat kryhen brenda rrezes së shikimit, por jashtë rrezes së dëgjimit të oficerëve të paraburgimit.

Me autorizim prej Administratorit, të paraburgosurit mund të kenë vizita nga përfaqësuesit e tyre konsullorë përmes videolidhjes.

8. QELIA E TË PARABURGOSURIT DHE LËVIZJET JASHTË QELISË

- **Qelia**

Çdo të paraburgosuri i caktohet një qeli më vete, përveçse kur në rrethana të jashtëzakonshme shefi i paraburgimit vendos ndryshe. Përdorimi i një qelie nga më shumë se një i paraburgosur për një periudhë më të gjatë se shtatë ditë bëhet me miratimin e Administratorit.

Në qeli ka pajisje dhe orendi të fiksuara dhe të pafiksuara standarde të cilat shënohen në listën e inventarit që nënshkruhet nga i paraburgosuri pas mbërritjes në objektin e paraburgimit dhe pasi i paraburgosuri ka verifikuar inventarin në qeli. Të paraburgosurit mund t'i kërkojë të paguajë për dëmet e shkaktuara pajisjeve dhe orendive të fiksuara e të pafiksuara, apo për sendet që mungojnë.

Të paraburgosurit nuk lejohen të mbulojnë ose pengojnë në asnjë lloj mënyre pamjen e dritares së inspektimit në derën e qelisë, ose të mbulojnë dritat në qeli.

- **Lëvizjet jashtë qelisë**

Shefi i paraburgimit lëshon dhe u komunikon të paraburgosurve orarin e hapjes së dyerve të qelive dhe kalendarin e aktiviteteve në bllok, si edhe ndryshimet në orarin dhe kalendarin e lartpërmendur.

Në varësi të faktorëve të sigurisë, të paraburgosurve u lejohej të lëvizin brenda:

- bllokut ku janë caktuar gjatë orarit të hapjes së dyerve;
- oborrit për ajrim dhe verandës gjatë orarit të caktuar për ajrim, apo aktivitete të tjera të kohës së lirë si p.sh., ushtrime fizike;
- palestrës dhe sallës së sporteve gjatë orarit të përcaktuar për përdorimin e tyre në bllokun e të paraburgosurve; dhe
- mjediseve të tjera si biblioteka, klasat, dhoma për nevoja fetare e shpirtërore, gjatë aktiviteteve të organizuara.

Të paraburgosurve u ndalohej të lëvizin në mjedise jashtë qelive të tyre pa leje paraprake të shefit të paraburgimit, zëvendësshefit të paraburgimit ose një përgjegjësi të ekipit të rojave. Nëse ndodhen në një mjedis ku nuk lejohet të jenë, ndaj të paraburgosurve mund të merren masa disiplinore.

Në dhomën për aktivitete të kohës së lirë brenda bllokut ndodhet një tabelë lajmërimesh ku publikohen orari i hapjes së dyerve të qelive, kalendarin e aktiviteteve në bllok dhe njoftime të tjera të rëndësishme për të paraburgosurit.

9. SENDET E NDALUARA

Në bazë të rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit, në objektin e paraburgimit janë të ndaluara një kategori sendesh ndër të cilat: lëngje dhe substanca ndezëse; cigare elektronike; telefona mobilë dhe pjesë të tyre; pajisje të tjera për komunikim; alkool, barna narkotike dhe substance psikotropike; medikamente, suplemente dhe vitamina, përveçse kur janë me recetë të lëshuar nga mjeku i Njesisë së Paraburgimit.

Shefi i paraburgimit mund të ndalojë edhe sende të tjera që mund të përdoren për qëllime të paligjshme, për shembull, për cenimin e sigurisë ose rregullit në objektin e paraburgimit, për kryerjen e një krimi, ose që mund të jenë rrezik për sigurinë e personave.

Sendet e ndaluara përcaktohen në Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit për Sendet dhe Substancat e Ndaluara në Objektin e Paraburgimit, që gjithashtu mund të gjendet në bllokun e të paraburgosurit. Të paraburgosurit duhet të njihen me këtë Udhëzim.

10. SHËRBIMI MJEKËSOR

Mjeku i Njesisë së Paraburgimit është mjeku parësor që trajton të gjithë të paraburgosurit. Të paraburgosurit mund të kërkojnë në çdo kohë ndihmë mjekësore. Për çdo procedurë ose trajtim mjekësor për të paraburgosurin, është i domosdoshëm pëlqimi i dhënë prej të paraburgosurit pasi të jetë informuar.

Mjeku i Njesisë së Paraburgimit i viziton të paraburgosurit rregullisht. Ai viziton çdo ditë ata të paraburgosur të cilët janë të sëmurë, të lënduar ose që janë në izolim. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit mban dosjet mjekësore të të paraburgosurve të cilat janë konfidenciale. Të paraburgosurit mund të bëjnë kërkesë për qasje në të dhënat e dosjes mjekësore sipas procedurës përkatëse në një udhëzim të veçantë.

Të paraburgosurit mund të konsultohen me mjekë të jashtëm, si doktorë ose dentistë, që i zgjedhin vetë dhe me shpenzimet e tyre. Mjekët e jashtëm duhet të kenë të drejtën e ushtrimit të profesionit në Kosovë, në Holandë, ose në shtetin e banimit të të paraburgosurit. Në rast se i mungojnë mjetet financiare për konsultim me një mjek të jashtëm, i paraburgosuri mund t'i parashtojë kërkesë Administratorit që Dhoma e Specializuarë të mbulojnë shpenzimet e trajtimit. Procedura e paraqitjes së kërkesës për konsultim me një mjek të jashtëm mund të rregullohet në një udhëzim të veçantë.

Mjeku i Njesisë së Paraburgimit ose personi i autorizuar prej tij, jep mjekimin ose trajtimin e rekomanduar nga mjeku i jashtëm, përveçse kur sipas mendimit profesional të mjekut të Njesisë së Paraburgimit, kjo nuk është në të mirën e të paraburgosurit.

11. USHQIMI

Në objektin e paraburgimit, të paraburgosurve u shërbehen tri shujta në ditë me shumëllojshmëri, të përgatitura dhe të shërbyera mirë, si edhe në cilësi dhe sasi të kënaqshme në përputhje me standardet e ushqyeshmërisë.

Në rast se dëshirojnë ta përgatisin vetë ushqimin e tyre, të paraburgosurit mund të përdorin pajisjet dhe mjediset për gatim dhe mund të blejnë me shpenzime të tyre artikujt në dyqanin e burgut. Të paraburgosurit nuk mund të mbajnë ushqime ose pije në qelitë e tyre. Ushqimet dhe pijet mbahen në dollapët dhe frigoriferët që gjenden në dhomën e aktiviteteve të kohës së lirë në bllok.

Mbrojtësit dhe vizitorët e tjerë nuk lejohen të sjellin ushqime ose pije për të paraburgosurit.

12. DYQANET

• Porositë për blerje

Së paku një herë në javë të paraburgosurit mund të bëjnë porosi për blerje ushqimesh dhe artikujsh të tjerë që gjenden në dyqanin e burgut. Të paraburgosurit duhet t'ia dorëzojnë listën e artikujve që dëshirojnë të blejnë oficerit të paraburgimit në bllokun e tyre. Zakonisht, të paraburgosurve u jepen artikujt e porositur në javën vijuese.

Në rast se të paraburgosurve u mungojnë mjetet financiare për blerje artikujsh, porosia e tyre nuk përmbushet. Në kësi rastesh të paraburgosurit mund t'ia paraqesin kërkesë Administratorit që të lejojë blerjen e disa artikujve për nevojat të ngutshme të tyre. Të paraburgosurit i bëjnë kërkesat me shkrim dhe ia dorëzojnë shefit të paraburgimit për t'ia përcjellë Administratorit.

Shefi i paraburgimit mund të përcaktojë sasinë maksimale për blerjet javore duke u bazuar në arsye praktike si p.sh. hapësira e kufizuar në dollapët, frigoriferët ose hapësirat e tjera për ruajtjen e artikujve, që përdoren në masë të barabartë nga të gjithë të paraburgosurit.

• Dorëzimi i artikujve të porositur

Oficerët e paraburgimit ua dorëzojnë artikujt të paraburgosurve dhe mbajnë shënim çfarëdo mospërputhje midis porosisë së të paraburgosurit dhe të artikujve që dorëzohen. Në qoftë se i paraburgosuri nuk ndodhet në bllok, oficeri i paraburgimit i lë artikujt në qelinë e të paraburgosurit dhe produktet e ngrira në frigoriferin e dhomës së aktiviteteve të kohës së lirë. Të paraburgosurit informohen për artikujt që iu dorëzohen dhe mund të paraqesin ankesa në rast se ka mospërputhje.

- **Dyqanet e jashtme**

Gjatë kohës së qëndrimit të të paraburgosurve në objektin e paraburgimit, mund të organizohet blerja e artikujve në dyqane të jashtme të caktuara. Në raste të tilla, të paraburgosurve u jepet mundësia të blejnë artikuj nga këto dyqane. Të paraburgosurit duhet të përdorin një formular të veçantë për porositë për blerje dhe kjo porosi paraqitet njëkohësisht me porositë për blerje në dyqanin e burgut. Zbatohet e njëjta procedurë si në rastin e blerjes dhe dorëzimit të artikujve nga dyqani i burgut.

13. LLOGARIA

Pas mbërritjes së një të paraburgosuri në objektin e paraburgimit, për atë çelet një llogari. Llogaritë e të paraburgosurve administrohen nga seksioni financiar i burgut. Llogaritë e të paraburgosurve kanë një numër TULP të cilin ata mund ta shohin në deklaratat javore të llogarisë së tyre.

Të paraburgosurit mund të mbajnë deri në 1.500 euro në llogaritë e tyre.

Meqenëse të paraburgosurit nuk lejohen të mbajnë para të gatshme me vete, të gjitha pagesat e tyre gjatë qëndrimit në objektin e paraburgimit kryhen përmes llogarisë së tyre, duke përfshirë edhe blerjet në dyqanin e burgut, në dyqane të jashtme, pastrimin kimik dhe thirrjet telefonike. Përmes llogarisë së një të paraburgosuri nuk mund të kryhen transaksione të tjera financiare përveç transferimeve financiare midis të paraburgosurve dhe vizitorëve të tyre, ose midis vetë të paraburgosurve sikurse përcaktohet më poshtë.

- **Transferimet financiare midis të paraburgosurve dhe vizitorëve të tyre**

Vizitorët mund të depozitojnë para në llogaritë e të paraburgosurve nga e hëna në të premte gjatë orarit të rregullt të vizitave të objektivit të paraburgimit, me përjashtim të ditëve të pushimeve zyrtare në Holandë. Në rast se një vizitor dëshiron të depozitojë më shumë se 500 euro në llogarinë e një të paraburgosuri, vizitori duhet të marrë leje me shkrim prej shefit të paraburgimit.

Në rast se një i paraburgosur dëshiron t'i japë para vizitorit (për shembull bashkëshortes/bashkëshortit, fëmijës, prindit) nga llogaria e vet, i paraburgosuri i paraqet një kërkesë me shkrim shefit të paraburgimit së paku 3 ditë pune para vizitës. Në kërkesë, i paraburgosuri shënon emrin e plotë të vizitorit të cilit ka ndër mend t'i japë para, si edhe shumën që ka ndër mend t'i japë vizitorit. Meqenëse i paraburgosuri nuk lejohet të mbajë para me vete gjatë qëndrimit në objektin e paraburgimit, punonjës të Njësisë së Paraburgimit tërheqin para nga llogaria e të paraburgosurit në emër të tij dhe pas vizitës ia dorëzojnë vizitorit gjatë largimit nga objekti i paraburgimit.

Transferimi i parave midis një të paraburgosuri dhe vizitorëve të vet kryhet vetëm përmes kësaj procedure.

Nuk pranohet depozitimi i parave të gatshme në valuta të tjera, përveçse në euro. Edhe transferimi dhe tërheqja e shumave mund të kryhen vetëm në euro.

- **Transferimet financiare midis të paraburgosurve**

Në rast se një i paraburgosur dëshiron t'i transferojë para një të paraburgosuri tjetër të Dhomave të Specializuara, atëherë i paraburgosuri duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim shefit të paraburgimit duke bërë të ditur arsyen legjitime për transferimin e parave. Përgjithësisht, shumë maksimale që një i paraburgosur mund t'i transferojë një të paraburgosuri tjetër nuk lejohet të jetë më shumë se 150 euro për kërkesë. Shefi i paraburgimit mund të refuzojë një kërkesë për transferim të hollash për

shkaqe të arsyeshme, ndër të cilat edhe kur transferimi i të hollave është i papajtueshëm me administrimin e duhur të drejtësisë.

Transferimi i parave midis të paraburgosurve kryhet vetëm përmes kësaj procedure.

14. VESHJA DHE SENDE TË TJERA PERSONALE

Gjatë qëndrimit në objektin e paraburgimit, të paraburgosurit mund të veshin teshat e tyre në qoftë se janë të pastra dhe nëse shefi i paraburgimit gjykon se janë të përshtatshme. Në rast nevojë, Njësia e Paraburgimit furnizon me veshje të përshtatshme të paraburgosurit të cilëve u mungojnë mjetet financiare. Të paraburgosurve nuk u lejohet të veshin tesa ose të mbajnë sende personale me shenja ose përmbajtje politike, ushtarake, kriminale, fyese ose diskriminuese.

Të paraburgosurit mund të mbajnë në objektin e paraburgimit sende personale në sasi të arsyeshme, me përjashtim të sendeve të ndaluara, ndër të cilat sendet që mund të përdoren për qëllime të paligjshme, për shembull që mund të përdoren për cenimin e sigurisë ose të rregullit në objektin e paraburgimit, ose për kryerjen e një krimi, ose që mund të përbëjnë rrezik për sigurinë e personave.

Të gjitha sendet e lejuara iu nënshtrohen kontrolleve të sigurisë dhe iu kthehen të paraburgosurve. Sendet që nuk lejohen, ose që për shkak të madhësisë ose sasisë së tyre, logjikisht nuk mund të mbahen në qelinë e të paraburgosurit, mbahen në një magazinë për ruajtje në objektin e paraburgimit. Sendet që amortizohen ose që logjikisht nuk mund të mbahen prej Dhomave të Specializuara, mund të asgjësohen. Të paraburgosurit nënshkruajnë për sendet që mbajnë në qelitë e tyre dhe për sendet që ruhen deri në lirimin ose transferimin e tyre nga objekti i paraburgimit. Për sende të tjera që të paraburgosurit dëshirojnë të marrin, për shembull përmes postës ose nga vizitorët, zbatohen procedura të ngjashme.

15. HIGJENA PERSONALE

Qelitë e të paraburgosurve kanë banja. Dushet ndodhen në mjediset e përbashkëta të bllokut. Në çdo kohë, të paraburgosurit duhet të mbajnë veten, qelitë, veshjet dhe sendet e tjera personale të tyre, të pastra e të rregullta. Kur përdorin mjediset e përbashkëta, si kuzhina, dhoma për aktivitete të kohës së lirë, dushet dhe mjediset për larjen e teshave, të paraburgosurit duhet t'i lënë këto mjedise në gjendje të pastër dhe të rregullt. Për këtë qëllim vihen në dispozicion mjete për pastrim.

Të paraburgosurve u jepen shtresa e mbulesa të përshtatshme që ndërrohen rregullisht.

Është përgjegjësi e të paraburgosurve që t'i mbajnë teshat e tyre të pastra dhe të rregullta. Pajisjet për larjen e teshave ndodhen në mjediset e përbashkëta në bllok. Nëse një i paraburgosur dëshiron dhe mund të paguajë vetë për shërbimin, Njësia e Paraburgimit mund të organizojë pastrimin kimik të kostumeve që i paraburgosuri vesh në seancat gjyqësore para Dhomave të Specializuara.

Gjithashtu, ofrohet rregullisht edhe shërbimi prej berberit.

16. AJRIMI DHE USHTRIMET FIZIKE

- **Ajrimi në oborr dhe në verandë**

Të paraburgosurit kanë qasje në oborrin për ajrim të paktën një orë në ditë ('ajrim'), me përjashtim të rasteve kur moti ose arsyet e sigurisë e kufizojnë përkohësisht qasjen. Gjatë kohës që janë në oborr, të paraburgosurve nuk u lejohej të komunikojnë me persona jashtë oborrit. Nëse nuk dëshiron të dalë në oborrin për ajrim, atëherë gjatë asaj kohe i paraburgosuri duhet të qëndrojë në qelinë e vet dhe qelia mbahet e mbyllur me çelës.

Nëse i paraburgosuri nuk mund të përdorë oborrin për ajrim për të paktën një orë gjatë orarit të planifikuar për arsye se nuk ndodhet në objektin e paraburgimit ose për arsye të tjera objektive, brenda së njëjtës ditë i paraburgosuri ka mundësinë të përdorë verandën për aq kohë sa ka humbur nga ajrimi njëorësh në oborr.

- **Palestra dhe salla e sporteve**

Brenda objektit të paraburgimit ndodhen një palestër e vogël dhe një sallë e sporteve. Të paraburgosurit mund t'i përdorin palestrën dhe sallën e sporteve në orarin e caktuar për bllokun e tyre. Nëse nuk dëshirojnë të ushtrohen në palestër ose në sallën e sporteve, gjatë kësaj kohe të paraburgosurit duhet të qëndrojnë në qelitë e veta të cilat, sipas rregullit, mbyllen me çelës. Shefi i paraburgimit mund të kufizojë përdorimin e palestrës dhe/ose të sallës së sporteve për arsye sigurie, ose nëse pajisjet përdoren në mënyrë të palejueshme.

- **Kontrolli mjekësor paraprak**

Nëse dëshiron të marrë pjesë në aktivitete sportive, i paraburgosuri **fillimisht** duhet të vizitohet prej mjekut të Njesisë së Paraburgimit i cili vlerëson gjendjen e tij fizike. Mundësia e një të paraburgosuri për pjesëmarrje në veprimtari sportive mund të kufizohet duke u bazuar në vlerësimin e mjekut të Njesisë së Paraburgimit.

17. AKTIVITETE TË TJERA

Të paraburgosurit mund ta përdorin bibliotekën në objektin e paraburgimit ku mund të huazojnë libra një herë në javë.

Gjithashtu, të paraburgosurit mund të blejnë me shpenzimet e veta dhe të mbajnë në qeli libra, gazeta dhe materiale të tjera për shkrim e lexim në sasi të përcaktuara në Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi Sendet dhe Substancat e Ndaluara në Objektin e Paraburgimit.

Të paraburgosurit gjithashtu mund të marrin materiale dhe pajisje të nevojshme për aktivitete që u pëlqejnë, me kusht që materiale të tilla të jenë në përputhje me kriteret e sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit, dhe me administrimin e duhur të drejtësisë, dhe për to të kenë marrë paraprakisht leje me shkrim nga shefi i paraburgimit.

Të paraburgosurit njoftohen për mundësi për pjesëmarrje në aktivitete mësimore, në qoftë se ofrohet një mundësi e tillë.

18. PIRJA E DUHANIT

Rregullat e pirjes së duhanit zbatohen në lidhje me cigaret, purot dhe produktet e tjera të duhanit. Për arsye sigurie, cigaret elektronike janë të ndaluara.

Gjatë kohës që pijnë duhan në qelitë e tyre dhe deri sa të largohet tymi i duhanit, të paraburgosurit mbajnë derën e qelisë të mbyllur. Kur nuk janë në qelitë e tyre, të paraburgosurit lejohen të pijnë duhan **vetëm** në mjediset e mëposhtme:

- në oborrin për ajrim;
- në qelinë për pirjen e duhanit në bllokun e tyre.

Të paraburgosurit mund të pijnë duhan në oborrin për ajrim gjatë orareve të caktuara për përdorimin e oborrit për ajrim, ose për aktivitete të tjera specifike të kohës së lirë, si për shembull ushtrime fizike. Jashtë këtyre orareve, të paraburgosurit nuk mund ta përdorin oborrin për ajrim vetëm për të pirë duhan.

Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha mjediset e tjera, duke përfshirë qelitë për mbajtjen e materialeve, verandën, palestrën, sallën e sporteve, dushet, mjediset për larjen e teshave dhe dhomat për printim, vizita dhe aktivitete të kohës së lirë.

Vizitorët dhe të paraburgosurit e kanë të ndaluar të sjellin produkte duhani në vizita. Ndalohen pauzat për pirje të duhanit gjatë vizitave.

Kur pijnë duhan, të paraburgosurit duhet të kujdesen që mos t'i ekspozojnë të tjerët ndaj tymit të cigares, dhe bishtat e hirin e cigares i hedhin me kujdes, duke i lënë mjediset për pirjen e duhanit të pastra dhe të rregullta.

Të paraburgosurve që e pijnë duhanin, në çfarëdo momenti të caktuar iu lejohet të kenë në zotërim më së shumti:

- 10 kuti cigare (200 cigare/ 1 stekë); ose
- 100 puro të holla; ose
- 50 puro të trasha; ose
- 250 gram duhan.

Në rast të seancave në selinë e Dhomave të Specializuara në Raamweg 47, pirja e duhanit në mjediset e selisë dhe në qelitë e pritjes është e ndaluar.

Për të paraburgosurit që nuk respektojnë rregullat e pirjes së duhanit mund të merren masa disiplinore.

Të paraburgosurit që e pijnë duhanin këshillohen posaçërisht që të kontaktojnë mjekun e Njesisë së Paraburgimit për mbështetje, këshilla dhe udhëzime në lidhje me dobinë e lënies së duhanit.

19. THIRRJET TELEFONIKE DHE POSTA

Të paraburgosurit mund të komunikojnë me telefon ose postë, në përputhje me kufizimet e domosdoshme dhe proporcionale që mund të caktohen nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara, Administratori ose shefi i paraburgimit. Në raste urgjente mund të merren masa të caktuara sigurie që ndikojnë në komunikimet e të paraburgosurve.

Të paraburgosurit i mbulojnë vetë shpenzimet e shërbimeve të telefonit dhe postës në objektin e paraburgimit, me tarifat e ofruesve përkatës të këtyre shërbimeve. Kur nuk kanë mundësi t'i mbulojnë

vetë shpenzimet për këto shërbime, të paraburgosurit mund të parashtrojnë një kërkesë me shkrim për mbulimin e tyre nga Dhomat e Specializuara.

- **Thirrjet telefonike**

I paraburgosuri mund të bëjë thirrje telefonike, përfshirë thirrje telefonike mbrojtësit të vet, gjatë orarit kur qelitë në bllokun e të paraburgosurit janë të hapura. Thirrjet hyrëse lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Në një rast të tillë, data, ora dhe numri i telefonit i thirrjes hyrëse, si edhe emri e mbiemri i thirrësit, shënohen në formularin përkatës dhe i jepen të paraburgosurit.

- *Linja e mbrojtur telefonike*

Zyra e administrimit mban listën e emrave dhe numrave të telefonit të mbrojtësve dhe bashkëmbrojtësve të të paraburgosurve. Të paraburgosurit mund të përdorin linjën e mbrojtur telefonike për t'i thirrur ata vetëm në këta numra telefoni. Mbrojtësit dhe bashkëmbrojtësit e të paraburgosurve mund t'i përditësojnë numrat e tyre të telefonit në listë me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar shefit të paraburgimit, duke plotësuar formularin përkatës.

Në qoftë se dëshiron të bëjë thirrje përmes linjës së mbrojtur telefonike, i paraburgosuri duhet ta informojë oficerin e paraburgimit të bllokut të vet për personin që dëshiron të kontaktojë. Njësia e Paraburgimit kontakton personin përkatës dhe ia transferon thirrjen të paraburgosurit.

Linja e mbrojtur telefonike mund të përdoret edhe për komunikime të tjera që konsiderohen konfidenciale sipas rregullores në fuqi, me kusht që emrat dhe numrat e telefonit të personave përkatës të jenë në listën e numrave të cilët të paraburgosurit mund t'i kontaktojnë përmes linjës së mbrojtur telefonike.

- *Linjat telefonike jo të mbrojtura*

Të paraburgosurit mund të përdorin telefonat me kartelë që gjenden në bllokun e tyre. Rimbushja mund të blihet nëpërmjet burgut.

Bisedat telefonike të të paraburgosurve përmes linjës telefonike jo të mbrojtur, incizohen. Për garantimin e sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit, shefi i paraburgimit mund të dëgjojë në javë deri në 10 për qind të numrit të bisedave telefonike të incizuara në format digjital. Këto biseda përzgjidhen në mënyrë rastësore, pa u përqendruar tek një i paraburgosur konkret.

- **Posta**

Të paraburgosurit mund të dërgojnë dhe marrin letra. Sikurse kërkohet në rrethana të sigurisë së lartë të objektit të paraburgimit, shefi i paraburgimit hap, inspekton dhe lexon letrat e marra dhe të dërguara prej të paraburgosurve brenda dy ditësh nga marrja e tyre, nëse është e realizueshme. Nuk hapen e as nuk lexohen letrat e mbrojtura prej konfidencialitetit të komunikimeve, përkatësisht letërkëmbimi i të paraburgosurve me mbrojtësit e tyre ose me autoritete specifike, si KNKK-ja, Avokati i Popullit, Administratori ose një anëtar i personelit që vepron në emër të Administratorit, një gjykatës apo panel i Dhomave të Specializuara ose anëtar i personelit që vepron në emër të tyre, apo cilido autoritet gjyqësor tjetër i njohur nga Administratori.

Të paraburgosurve ua sjellin letrat oficerët e paraburgimit. Në qoftë se i paraburgosuri nuk është në bllok, oficerët e paraburgimit e lënë letrën në qelinë e të paraburgosurit përkatës, duke siguruar që

asnjë i paraburgosur tjetër të mos ketë qasje në atë letër. Posta dalëse e të paraburgosurve, mbledhet dy herë në ditë.

20. VIZITAT

Të paraburgosurit mund të vizitohen nga vizitorë të autorizuar në varësi të kufizimeve të domosdoshme dhe proporcionale që mund të caktojnë gjykatësit e Dhomave të Specializuara, Administratori ose shefi i paraburgimit. Në rrethana urgjente mund të merren masa të caktuara sigurie që ndikojnë mbi vizitat që u bëhen të paraburgosurve.

Përgjithësisht, të gjithë vizitorët duhet të kenë leje për vizitë.

Njësia e Paraburgimit mundëson vizita midis të paraburgosurve dhe **të afërmeve të ngushtë** të tyre. Në kontekstin e vizitave prej familjes, në **të afërm të ngushtë** përfshihen bashkëshortja/bashkëshorti, partnerja/partneri, prindërit, fëmija, fëmija i fëmijës, vëllai, motra (ku përfshihen edhe vëllezër e motra vetëm prej nënës ose babait dhe vëllezër e motra të gjetura), gjyshërit, si edhe dhëndri dhe nusja. Të afërmit e ngushtë në përgjithësi marrin leje vjetore për të vizituar të paraburgosurit. **Të afërmit e ngushtë të cilëve u duhet vizë** për hyrje në Holandë, duhet të kontaktojnë zyrën e administrimit (duke dërguar mesazh në adresën visitors-DMU@scp-ks.org) **shumë më përpara** vizitës së planifikuar. Procedura e parashtrimit të kërkesës për leje vjetore për vizita përcaktohet në Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi Procedurat e Vizitave nga Anëtarë të Familjes dhe Vizitorë të tjerë Personalë.

I paraburgosuri/eparaburgosura lejohet të takojë **bashkëshorten/bashkëshortin** ose **partneren/partnerin** dhe/ose **fëmijët** në **vizitë private**, së paku një herë në 3 muaj për më së shumti 3 orë. Procedura e parashtrimit të kërkesës për vizitë private përcaktohet në Shtojcën A me titull 'Vizitat Private' të Udhëzimit të Njesisë së Paraburgimit mbi mbi Procedurat e Vizitave nga Anëtarë të Familjes dhe Vizitorë të tjerë Personalë.

Mbrojtësve të të paraburgosurve iu miratohen vizita të rregullta. Procedura e planifikimit të vizitave nga mbrojtësit përcaktohet në pjesën 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart.

• Oraret e vizitave

Oraret e vizitave për familjarët dhe persona të tjerë që vizitojnë të paraburgosurit janë si vijon:

- midis orës 9:00 dhe 16:45 nga e hëna në të premte; dhe
- midis orës 9:00 dhe 16:00 të shtunave dhe të dielave.

Orari i vizitave për mbrojtësit përcaktohet në pjesën 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart.

Oraret e vizitave mund të ndryshojnë për arsye të numrit të punonjësve ose për arsye të tjera operative. Për këto ndryshime, të paraburgosurit informohen mjaft përpara, kur është e mundshme.

• Kërkesa për leje për vizitë

Në përgjithësi, vizitorët, me përjashtim të të afërmeve të ngushtë, duhet të kërkojnë leje për vizitë me anë të parashtrimit të një kërkesë për leje për vizitë, së paku 15 ditë kalendarike para datës së propozuar për vizitë, duke plotësuar formularin standard të kërkesës që gjendet në faqen e Internetit

të Dhomave të Specializuara. Nëse dëshirojnë të presin vizitorë, të paraburgosurit duhet t'i bëjnë kërkesë me shkrim zyrës së administrimit së paku 10 ditë para datës së propozuar për vizitë.

Për të afërmit e ngushtë që bëjnë kërkesë për leje vjetore për vizitë vlejné afate të tjera. Oraret e vizitave përcaktohen në Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi mbi Procedurat e Vizitave nga Anëtarë të Familjes dhe Vizitorë të tjerë Personalë.

Vizitorë të caktuar, si mbrojtësit e të paraburgosurve, përfaqësuesit e KNKK-së, Avokati i Popullit, Administratori ose një anëtar i personelit që vepron në emër të Administratorit, një gjykatës apo panel i Dhomave të Specializuara ose një anëtar i personelit që vepron në emër të tyre, nuk kanë nevojë të bëjnë kërkesë për leje për vizitë.

Të paraburgosurit i bëhet i ditur identiteti i çdo vizitori dhe mund të refuzojë të takojë cilindo nga vizitorët, përveç Administratorit.

- **Planifikimi i vizitës**

Vizitorëve që nuk kanë planifikuar paraprakisht vizitë me zyrën e administrimit, normalisht nuk u lejohet hyrje në burg dhe në objektin e paraburgimit.

Për vizitorët që nuk janë të afërm të ngushtë, leja e dhënë për vizitë zakonisht mban datën dhe orarin e caktuar të vizitës. Nuk është e nevojshme që vizitorët ta planifikojnë vizitën veças, por për çdo herë që dëshirojnë të bëjnë vizitë, duhet të bëjnë kërkesë të re.

Të afërmit e ngushtë që kanë leje vjetore për vizitë, duhet ta planifikojnë vizitën së paku 10 ditë para datës së planifikuar të vizitës, duke kontaktuar zyrën e administrimit në adresën elektronike visitors-DMU@scp-ks.org.

Edhe *mbrojtësit* e të paraburgosurve duhet t'i planifikojnë vizitat me klientët e tyre paraprakisht (shih pjesën 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart).

Në përputhje me rregullën 7 të Rregullores së Paraburgimit, KNKK-ja dhe Avokati i Popullit mund të kryejnë inspekte të palajmëruara të objektivit të paraburgimit.

- **Sendet për të paraburgosurit**

Vizitorëve nuk u lejohet që t'u japin të paraburgosurve sende drejtpërsëdrejti. Vetëm në vizitat e *mbrojtësve*, të paraburgosurit mund të marrin drejtpërsëdrejti nga mbrojtësit e tyre dokumente shkresore për përgatitjen e mbrojtjes (shih pjesën 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart).

Kur dëshirojnë të marrin sende nga vizitorët e tyre, të paraburgosurit duhet t'i dorëzojnë shefit të paraburgimit një kërkesë me shkrim së paku 5 ditë para vizitës, ku specifikojnë sendet që dëshirojnë të marrin dhe prej kujt. Është përgjegjësi e të paraburgosurve që të informojnë vizitorët e tyre se cilat sende janë të lejuar të sjellin vizitorët me autorizim të shefit të paraburgimit.

Vizitorët mund t'i sjellin sendet e autorizuara në objektin e paraburgimit vetëm gjatë vizitave me të paraburgosurit. Vizitorët ua dorëzojnë ato anëtarëve të personelit të Njesisë së Paraburgimit në hyrjen e burgut midis orës 8:45 dhe 9:15, nga e marta në të premte. Të paraburgosurve nuk mund t'u sillen sende gjatë vizitave të planifikuara për ditët e hëna, të shtuna dhe të diela.

- **Sendet që sillen në vizita**

- *Sendet që sjellin vizitorët*

Në vizita, vizitorëve nuk u lejonet të sjellin asnjë send, përfshirë sende të ndaluara (shih pjesën 9. SENDET E NDALUARA më lart), me përjashtim të:

- sendeve që vizitorëve u nevojiten për *arsye shëndetësore*, si për shembull pompë për astmë, karrige me rrota për invalidë, ose shkop për të ecur, me kusht që të përligjin përdorimin e tyre për arsye shëndetësore;
- sendeve të autorizuar për *fëmijë* të moshës deri në 4 vjeç. Nëse për këta fëmijë nevojitet ushqim ose pije gjatë vizitës, të paraburgosurit duhet t'i parashtrijnë paraprakisht shefit të paraburgimit një kërkesë me shkrim për lejin e artikujve të caktuar. Për këtë arsye, është me rëndësi që të paraburgosurit t'i bashkërendojnë këto aspekte me vizitorët e tyre para vizitave.
- sendeve të lejuara në vizitat me mbrojtësit (shih pjesën 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart).

- *Sendet që sjellin të paraburgosurit*

Të paraburgosurit mund të sjellin sendet në vijim:

- në të gjitha vizitat: ushqim dhe pije, dhe sipas nevojës pjata, tabaka, ose enë për mbajtjen e tyre. Të paraburgosurit këshillohen që të sjellin ushqim dhe pije në sasinë që do të konsumohet gjatë vizitës, meqenëse vetëm artikujt që nuk janë hapur dhe janë plotësisht të vulosur dhe në paketimin original të tyre mund të kthehen në bllok pas përfundimit të vizitës. Të gjithë artikujt e tjerë të konsumueshëm duhet të hidhen në koshat e mbeturinave në mjediset e vizitave.
- në vizitat me anëtarë të familjes dhe miq: lojë me letra ose lojëra të tjera të ngjashme tavoline.
- në vizitat me mbrojtësit: sende të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes (shih pjesën 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart).

Sendet që të paraburgosurit dëshirojnë të sjellin në vizitë nuk mund të jenë më shumë se sa vëllimi i kutisë që u jepet për këtë qëllim.

Më së voni 15 minuta para fillimit të vizitës, të paraburgosurit duhet t'i vendosin të gjitha sendet në kuti dhe t'ia dorëzojnë kutinë oficerit të paraburgimit në bllokun e tyre për evidentimin dhe verifikimin e sendeve të ndaluara. Të paraburgosurit nuk lejohen që në vizita të sjellin sende të tjera, përveç atyre të vendosura në kuti.

Nëse kutia që u jepet për këtë qëllim nuk i nxë disa nga sendet që dëshirojnë të sjellin në vizitë, të paraburgosurit mund t'i parashtrijnë shefit të paraburgimit një kërkesë me shkrim për leje për sende shtesë. Kjo kërkesë duhet të bëhet së paku 1 ditë të plotë pune para vizitës.

- *Shkëmbimi i sendeve gjatë vizitave*

Gjatë vizitave, të paraburgosurit nuk mund të shkëmbejnë sende drejtpërsëdrejti me vizitorët. Vetëm në vizitat me mbrojtësit, të paraburgosurit mund të shkëmbejnë drejtpërsëdrejti me mbrojtësit e tyre dokumente shkresore për përgatitjen e mbrojtjes (shih pjesa 6. SHËRBIMET JURIDIKE më lart).

Nëse dëshirojnë që t'u japin sende vizitorëve të tyre, të paraburgosurit ua dorëzojnë këto sende anëtarëve të personelit të Njësisë së Paraburgimit së paku 1 ditë pune para vizitës në mënyrë që të bëhet verifikimi për sende të ndaluara, si dhe plotësojnë formularin përkatës për nxjerrjen e sendeve nga objekti i paraburgimit.

- **Procedura e vizitave**

Në përgjithësi, vizitat kryhen brenda rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit.

Vizitat e mëposhtme kryhen brenda rrezes së shikimit, por jashtë rrezes së dëgjimit të oficerëve të paraburgimit:

- vizitat me mbrojtësit;
- vizitat me autoritete gjyqësore të njohura nga Administratori;
- vizitat me përfaqësues konsullorë të shtetit të të paraburgosurit.

Vizitat e mëposhtme kryhen jashtë rrezes së shikimit dhe dëgjimit të oficerëve të paraburgimit:

- Vizitat private të të paraburgosurit/paraburgosurës me bashkëshorten/bashkëshortin apo partneren/partnerin dhe/ose fëmijët;
- vizitat me përfaqësues të KNKK-së;
- vizitat me Avokatin e Popullit;
- vizitat me Administratorin e Dhomave të Specializuara ose anëtarë të personelit që veprojnë në emër të Administratorit;
- vizitat me gjykatës të Dhomave të Specializuara ose anëtarë të personelit që veprojnë në emër të tyre.

Të paraburgosurit dhe vizitorët e tyre në moshë madhore janë përgjegjës kryesorë për sigurinë dhe sjelljen e duhur të fëmijëve të moshës së mitur në mjediset për vizita. Oficerët e paraburgimit mund t'i udhëzojnë të paraburgosurit dhe vizitorët e tyre në moshë madhore që t'i mbajnë fëmijët më shumë në mbikëqyrje. Mosrespektimi i këtyre udhëzimeve mund të çojë në dhënien fund të vizitës.

- **Pas vizitave**

Pas kryerjes së vizitës, kutia me sendet që i paraburgosuri ka sjellë në vizitë, kontrollohet për sende të ndaluara.

- **Vizitat përmes videolidhjes**

Me autorizim të Administratorit, të paraburgosurit lejohen të kenë vizita nga të afërm të ngushtë përmes videolidhjes në bazë të cilësdo procedure të parashtruar në një udhëzim të veçantë.

21. MIRËQENIA SHPIRTËRORE

Të paraburgosurit mund të bëjnë të ditur në çdo kohë se dëshirojnë të vendosin kontakt me një këshilltar fetar ose shpirtëror. Administratori mund të autorizojë vizita nga përfaqësues të kualifikuar të besimeve fetare ose bindjeve të të paraburgosurve. Në masën që është praktikisht e mundshme dhe në varësi vetëm të kufizimeve të nevojshme për ruajtjen e sigurisë ose të rregullit në objektin e paraburgimit, të paraburgosurve u lejohet të kenë në zotërim sasi të arsyeshme librash, literature ose udhëzuesish që lidhen me besimet fetare ose bindjet e tyre. Të paraburgosurit gjithashtu mund t'i parashtrojnë shefit të paraburgimit kërkesë për leje për pjesëmarrje në shërbesa, ceremoni, ose tubime të mundshme që mbahen në objektin e paraburgimit.

22. VAJTJA NË SEANCA GJYQËSORE DHE MUNGESA NGA SEANCAT GJYQËSORE

Kur largohen nga objekti i paraburgimit për të qenë të pranishëm në seanca gjyqësore para Dhomave të Specializuara, të paraburgosurit mund të marrin një çantë të vogël dore ku mbajnë mjete shkrimi dhe dokumente shkresore në lidhje me çështjen gjyqësore të tyre para Dhomave të Specializuara.

Kur dëshirojnë të marrin edhe CD dhe/ose DVD me materiale në lidhje me çështjen e tyre gjyqësore, të paraburgosurit zbatojnë procedurën për nxjerrjen e mediave joshkresore digjitale nga objekti i paraburgimit. Të paraburgosurve u ndalohet nxjerrja e drejtpërdrejtë e CD-ve dhe/ose DVD-ve të tilla nga objekti i paraburgimit. Të paraburgosurit i merret çdo send i tillë që zbulohet në zotërim të tij.

Në qoftë se nuk ndjehet mirë me shëndet e si pasojë nuk është në gjendje të jetë fizikisht i pranishëm në seancë gjyqësore në Dhomat e Specializuara, i paraburgosuri e informon pa vonesë oficerin e paraburgimit në bllokun e vet. Në një rast të tillë, të paraburgosurit i kërkohet t'i telefonojë mbrojtësit dhe të plotësojë formularin përkatës. I paraburgosuri ekzaminohet nga një ndihmësmjek i kualifikuar. Në qoftë se konstatohet se gjendja është serioze, kontaktohet edhe mjeku i Njesisë së Paraburgimit.

23. KONTROLLET

• Kontrollet trupore

Ka dy lloje kontrollesh trupore të të paraburgosurve që oficerët e paraburgimit mund t'i kryejnë në mënyrën e duhur (shih Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi Kontrollimin e të Paraburgosurve në Objektivin e Paraburgimit):

- kontrolli trupor sipër teshave (i nivelit A ose i nivelit B), që kryhet mbi trupin e veshur të të paraburgosurit; dhe
- kontrolli i plotë trupor, që përfshin heqjen e pjesshme ose të plotë të teshave të të paraburgosurit, pa zhveshjen e pjesës së sipërme dhe të poshtme të trupit në të njëjtën kohë.

Kontrollet kryhen në një mënyrë që respekton dinjitetin e të paraburgosurit, përmes zbatimit të metodës më pak ndërhyrëse, bazuar në kriteret e domosdoshmërisë dhe të proporcionalitetit.

Kontrolli trupor sipër teshave i një të paraburgosuri (i nivelit A ose i nivelit B) mund të kryhet kur është i domosdoshëm për të garantuar sigurinë dhe rregullin në objektin e paraburgimit. Ky kontroll kryhet çdo herë që i paraburgosuri largohet nga blloku i vet, ose kthehet në bllokun e vet.

Shefi i paraburgimit mund të urdhërojë kontroll të plotë trupor të një të paraburgosuri kur ai vetë ose oficeri i paraburgimit kanë arsye për të dyshuar se i paraburgosuri ka në zotërim një send të ndaluar sipas rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit (shih Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi Sendet dhe Substancat e Ndaluara në Objektivin e Paraburgimit) dhe ky send mund të zbulohet vetëm me heqjen e teshave të të paraburgosurit.

• Kontrolli i qelive

Qelitë e të paraburgosurve inspektohen çdo ditë dhe kontrollohen rregullisht si pjesë e rutinës së zakonshme në objektin e paraburgimit. Shefi i paraburgimit mund të autorizojë kontroll të posaçëm të qelisë së një të paraburgosuri në qoftë se ekziston dyshim i arsyeshëm se në qeli ka ndonjë send të ndaluar sipas rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit (shih Udhëzimin e Njesisë së Paraburgimit mbi Sendet dhe Substancat e Ndaluara në Objektivin e Paraburgimit). Përgjithësisht, të paraburgosurit kanë mundësi të jenë të pranishëm gjatë kontrollit të qelive të tyre.

- **Kontrolli i vizitorëve**

Kontrolli i vizitorëve përcaktohet në Udhëzimin e Njësisë së Paraburgimit mbi Kushtet e Sigurisë për Hyrje në Objektivin e Paraburgimit, i cili u vihet në dispozicion vizitorëve.

24. MASAT SHTRËNGUESE DHE TË KONTROLLIT

Mjetet shtrënguese, si për shembull prangat, përdoren për të paraburgosurit vetëm në disa rrethana të caktuara, ndër të tjera si masë parandaluese kundër arratisjes, për ta parandaluar lëndimin e të tjerëve, ose kur shefi i paraburgimit ka arsye për të besuar se shtrëngimi është i domosdoshëm për garantimin e sigurisë ose rregullit në objektin e paraburgimit.

Oficerët e paraburgimit mund të marrin masa të arsyeshme kontrolli ndaj të paraburgosurve dhe personave të tjerë në objektin e paraburgimit, përfshirë vizitorët. Sidoqoftë, oficerët e paraburgimit mund të përdorin forcën, me përjashtim të forcës vdekjeprurëse, vetëm për arritjen e disa qëllimeve legjitime të përcaktuara, si për shembull, për të mbrojtur personat e tjerë nga një kërcënim i menjëhershëm për lëndim trupor, ose për të parandaluar një kërcënim të rëndë ndaj sigurisë ose rregullit në objektin e paraburgimit.

25. DISIPLINA E TË PARABURGOSURVE

Oficerët e paraburgimit mbikëqyrin të paraburgosurit dhe mbajnë kontroll me drejtësinë dhe vendosmërinë e nevojshme për garantimin e sigurisë dhe rregullit në objektin e paraburgimit. Të paraburgosurit duhet t'u binden urdhrave dhe udhëzimeve të oficerëve të paraburgimit, si edhe Rregullores së Paraburgimit, udhëzuesve të punës të miratuar në bazë të saj, dhe rregulloreve e udhëzimeve të tjera me shkrim mbi sjelljen e të paraburgosurve, të miratuara nga Administratori ose të lëshuara nga shefi i paraburgimit. Një i paraburgosur kryen shkelje disiplinore nëse nuk respekton cilëndo prej tyre pa pasur arsye të përligjur. Sjellja e paligjshme, si për shembull, dhuna ndaj të tjerëve, mbajtja në zotërim e parave të gatshme ose sendeve të ndaluara sipas rregullës 25 të Rregullores së Paraburgimit (shih Udhëzimin e Njësisë së Paraburgimit mbi Sendet dhe Substancat e Ndaluara në Objektivin e Paraburgimit), përbëjnë shkelje disiplinore.

Procedimet disiplinore ndërmerren si mjet i fundit. Të paraburgosurit ndëshkohen për shkelje disiplinore në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Disiplinën. Të paraburgosurit kanë të drejtë të apelojnë një vendim disiplinor, në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Disiplinën. Në bllokun e tyre, të paraburgosurit mund të gjejnë formularin standard për apelimin e vendimeve disiplinore. Të paraburgosurit e plotësojnë formularin në një gjuhë që e kuptojnë.

26. ANKESAT E TË PARABURGOSURVE

Të paraburgosurit mund të parashtrojnë ankesë në lidhje me trajtimin dhe kushtet e paraburgimit të tyre në objektin e paraburgimit në përputhje me Udhëzuesin e Punës për Ankesat. Procedura e parashtrimit të ankesës përcaktuar në Udhëzuesin e Punës për Ankesat dallon nga procedura disiplinore e përshkruar më lart (shih pjesën 25. DISIPLINA E TË PARABURGOSURVE). Në bllokun e tyre, të paraburgosurit mund të gjejnë kopje të dokumentit të procedurës së ankesave.

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Shtojca A Rregullorja e Brendshme e Objektivit të Paraburgimit
KSC-BD-29

Në bllok, të paraburgosurit gjithashtu mund të gjejnë formularin standard për ankesat, të cilin e plotësojnë në gjuhën e tyre. Normalisht, të gjitha **ankesat** me shkrim të paraburgosurit duhet t'ia drejtojnë së pari shefit të paraburgimit, përveçse kur ankohen në lidhje me një vendim të Administratorit ose sjelljen e shefit të paraburgimit. Në secilin rast, të paraburgosurit gjithmonë e dorëzojnë ankesën tek një oficer i paraburgimit për t'ia përcjellë personit të duhur. As oficerët e paraburgimit, e as persona të tjerë, nuk censurojnë në asnjë lloj mënyre ankesat e të paraburgosurve.

Nëse nuk pajtohen me një vendim mbi ankesën, të paraburgosurit kanë të drejtë të parashtrojnë **kërkesë për rishikimin** e atij vendimi. Formulari standard i kërkesës për rishikim gjendet në bllokun e të paraburgosurve, dhe të paraburgosurit e plotësojnë atë në gjuhën e tyre. Edhe në këtë rast, të paraburgosurit ia dorëzojnë kërkesën për rishikim një oficeri të paraburgimit i cili nga ana e vet ia përcjell kërkesën Administratorit ose një gjykatësi të Dhomave të Specializuara. Kërkesat e të paraburgosurve nuk censurohen në asnjë lloj mënyre.

Në tabelën e mëposhtme tregohen afatet për parashtrimin e ankesave ose kërkesave për rishikim:

Lloji	Afati
<u>Ankesë</u> drejtuar shefit të paraburgimit në lidhje me trajtimin e të paraburgosurit ose kushtet e paraburgimit në objektin e paraburgimit	Brenda 30 ditësh kalendarike nga dita kur trajtimi ose kushtet për të cilat i paraburgosuri ankohet kanë ndikuar drejtpërsëdrejti mbi të paraburgosurin
Kërkesë drejtuar Administratorit për <u>rishikim</u> të vendimit të shefit të paraburgimit mbi ankesën e të paraburgosurit	Brenda 30 ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të shefit të paraburgimit
<u>Ankesë</u> parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit në lidhje me sjelljen e shefit të paraburgimit	Brenda 30 ditësh kalendarike nga dita kur sjellja për të cilën i paraburgosuri ankohet ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë mbi të paraburgosurin
<u>Ankesë</u> parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit ku kërkohet rishikimi i një vendimi me shkrim të marrë paraprakisht nga Administratori	Brenda 30 ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit
<u>Kërkesë për rishikim</u> nga një panel kompetent	Brenda 30 ditësh kalendarike nga marrja e vendimit me shkrim të Administratorit në përgjigje të një ankese ose kërkesë për rishikim të parashtruar drejtpërsëdrejti Administratorit

27. DOSJA PERSONALE

Njësia e Paraburgimit mban dosje personale për çdo të paraburgosur. Dosja personale përfshin listën e parave, teshave dhe gjësendeve të tjera të të paraburgosurit, informacion në lidhje me kufizime të vizitave dhe komunikimeve, vërejtjet që i janë dhënë të paraburgosurit, procedimet disiplinore kundër të paraburgosurit, të gjitha komunikimet me shkrim midis të paraburgosurit dhe Njesisë së Paraburgimit dhe Zyrës Administrative që kanë të bëjnë me mbajtjen e të paraburgosurit në objektin

Dhomat e Specializuara të Kosovës
Shtojca A Rregullorja e Brendshme e Objektivit të Paraburgimit
KSC-BD-29

e paraburgimit, dhe të dhëna të tjera. Dosja personale nuk përmban të dhënat mjekësore të të paraburgosurit të cilat ruhen veças nga mjeku i Njesisë së Paraburgimit. Dosja personale e të paraburgosurit ruhet dhe përpunohet në mënyrë konfidenciale, në përputhje me standardet e Dhomave të Specializuara për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të paraburgosurit kanë të drejtë të kenë qasje në dosjet personale të tyre, përveç të dhënave për të cilat shefi i paraburgimit në këshillim me Administratorin vendos se nuk duhen nxjerrë për arsye të sigurisë ose të administrimit të duhur të objektivit të paraburgimit. Për qasje në dosjet e tyre personale, të paraburgosurit duhet t'i parashtrijnë kërkesë me shkrim shefit të paraburgimit, në përputhje me udhëzimin përkatës.



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Shtojca B

Përdorimi i qelive për mbajtjen e dokumenteve

PËRMBAJTJA

PJESA 1	Dispozita të përgjithshme.....	1
PJESA 2	Qasja.....	1
PJESA 3	Mirëmbajtja.....	2

Pjesa 1 Dispozita të përgjithshme

1. Në rast të sasive të mëdha të materialeve për përgatitjen e mbrojtjes, i paraburgosuri mund t'i paraqesë kërkesë shefit të paraburgimit për një qeli për mbajtjen e dokumenteve, e cila zakonisht gjendet në bllokun ku ndodhet qelia e të paraburgosurit, për të mbajtur materiale që lidhen me çështjen gjyqësore, përfshirë edhe CD dhe DVD, sikurse parashihet në rregullën 26 të Rregullores së Paraburgimit.
2. Nëse disa të paraburgosur paraqesin kërkesë për një qeli për mbajtjen e dokumenteve dhe kërkesat e tyre janë të përligjura, secilit të paraburgosur i jepet një dollap i veçantë në qelinë për mbajtjen e dokumenteve. Mbi dollap shënohet qartë emri i të paraburgosurit të cilit i është caktuar dollapi. I paraburgosuri nuk përdor asnjë dollap tjetër.
3. Të paraburgosurit i përdorin qelitë ose dollapët për mbajtjen e dokumenteve vetëm për materiale që lidhen me çështjen gjyqësore. Ata nuk vendosin aty asnjë send tjetër, si tesha, ushqime, apo pije.

Pjesa 2 Qasja

1. Në përgjithësi, të paraburgosurve u lejohe qasje në qelitë në dollapët për mbajtjen e dokumenteve gjatë orëve kur qelitë janë të hapura, për të çuar ose për të marrë materiale prej qelive për mbajtjen e dokumenteve ose dollapëve.
2. Të paraburgosurve u lejohe qasje jashtë orarit të hapjes së qelive nëse është e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe gjatë:
 - a. orarit të mbylljes së qelive gjatë ditës; dhe/ose
 - b. orëve të planifikuara për aktivitete gjatë ditës, si për dalje në ajër të pastër ose sport.
3. Nëse një i paraburgosur dëshiron të ketë qasje në qelinë për mbajtjen e dokumenteve, ai ia paraqet kërkesën oficerit të paraburgimit në bllok. Në rast se i paraburgosuri dëshiron të ketë qasje gjatë

orëve të parapara në paragrafin 2, ai bën kërkesë për këtë përpara se të fillojë mbyllja e qelive apo aktiviteti përkatës.

4. Qasja në qelinë për mbajtjen e dokumenteve dhe, sipas rastit, në dollapin përkatës, mundësohet pa vonesa të panevojshme, përveç nëse nuk mund bëhet për shkak të arsyeve operative. Në rast qasjeje gjatë orëve të parapara në paragrafin 2, i paraburgosuri qëndron në qelinë për mbajtjen e dokumenteve gjatë gjithë periudhës së mbylljes së qelive ose aktivitetit.
5. Qelitë për mbajtjen e dokumenteve qëndrojnë të kyçura gjatë kohës që nuk janë në përdorim. Të paraburgosurit i lejohet qasje vetëm në dollapin e tij. Në të nuk i lejohet qasje asnjë të paraburgosuri tjetër.

Pjesa 3 Mirëmbajtja

1. I paraburgosuri e mban qelinë për mbajtjen e dokumenteve dhe dollapin që i është caktuar të pastër e të rregullt. I paraburgosuri nuk sjell ushqime apo pije, dhe as nuk pi duhan në qelinë për mbajtjen e dokumenteve. Moszbatimi i këtyre kushteve mund të rezultojë në heqjen e të drejtës për të pasur qeli për mbajtjen e dokumenteve apo dollap, sipas rastit.
2. I paraburgosuri mund të kërkojë leje për të sjellë ndonjë ushqim ose pije në qelinë për mbajtjen e dokumenteve në rast se do të qëndrojë aty më gjatë, sidomos gjatë periudhave të mbylljes së qelive apo aktiviteteve të planifikuara gjatë ditës.